



## **Fetë, kulturat, etika: informacione për prindërit**

### **Të bashkëjetosh me njerëz të kulturave të ndryshme**

Fëmijët dhe të rinjtë në përditshmërinë e tyre hasin në njerëz të prejardhjeve, të feve dhe të botëkuptimeve të ndryshme. Shumëllojshmëria është një karakteristikë qenësore e shoqërisë sonë. Bindjet fetare dhe botëkuptimet nxisin për pyetje. Mësimi në kuadër të lëndës «Fetë, kultura, etika» merret me këto çështje dhe ndihmon në zbulimin e të përbashkëtave dhe të të ndryshmeve.

#### **Fetë dhe kulturat**

Sie dhe pse festojnë njerëzit? Si e mbarështojnë ata përditshmërinë e tyre? Cilat botëkuptime janë të rëndësishme për ta? Cilat rregulla i kanë ata parasysh? Si janë ndikuar kulturat nga bindjet fetare? Shqyrtimi i çështjeve të tilla me fëmijët dhe të rinjtë ia vlen. Kjo ndihmon që ata ta kuptojnë botën në të cilën jetojnë dhe t'i respektojnë nejrëzit me sfond të ndryshëm fetar, kulturor dhe botëkuptimor.

#### **Etika dhe filozofimi**

Duke menduar mbi përvojat kryesore jetësore si frika, ngrohtësia, sukcesi, dështimi, lindja, sëmundja, vdekja, fëmijët dhe të rinjtë bëhen të vetëdijshëm mbi konceptet më të rëndësishme: drejtësinë, lirinë, përgjegjësinë, dinjitetin njerëzor. Filozofimi mund ta pasurojë të mësuarit në të gjitha lëndët dhe të ndihmojë në qasjen çështjeve kontradiktore dhe sfidave etike.

#### **Qëllimet në planin mësimor**

- Nxënëset dhe nxënësit kuptojnë se sa është e pranishme feja në shoqëri.
- Ata njihen me traditat karakteristike të feve të ndryshme
- Ata kuptojnë domethënien e traditave fetare në shoqëri.
- Ata mund të kuptohen me njerëz të bindjeve dhe të botëkuptimeve të ndryshme, të kuptohen në jetën e përditshme me njerëzit e feve dhe të kulturave të ndryshme.
- Ata respektojnë qëndrimet e ndryshme ndaj jetës dhe ndaj vlerave
- Ata iu qasën çështjeve filozofiko-etike të përditshmërisë

#### **Pikërendesat në ciklin e ulët (“Primarschule”)**

Nxënëset dhe nxënësit iu qasën temave dhe aspekteve të ndryshme të fesë, që i hasin në shkollë dhe në përditshmëri. Ata njihen posaçërisht me përmbajtjet elementare, me traditat dhe zakonet e krishterimit që kanë karakterizuar dhe karakterizojnë ende kulturën dhe shoqërinë e Kantonit të Cyrihut.

Fëmijët mendojnë mbi pyetjet të cilave s'mund t'ju jepet përgjigje e menjëhershme dhe mbi

sfidat, vlerat dhe normat, që përcaktojnë bashkëjetesën.

### **Pikërendesat në ciklin e lartë (“Sekundarschule”)**

Në ciklin e lartë, nxënëset dhe nxënësit përfitojnë njohuri themelore mbi fetë e mëdha botërore: krishterimin, hebraizmin, islamizmin, hinduizmin dhe budizmin, ata njihen kështu me atë se si njerëzit iu qasen traditave të tyre fetare dhe kulturore.

Të rinjtë marrin parasysh sfidat dhe mësojnë t'i shpjegojnë edhe vlerat dhe normat, t'i arsyetojnë vendimet dhe të marrin përgjegjësi për to.

### **«Fetë, kulturat, etika»**

Fëmija Juaj merr mësim në lëndën «Fetë, kulturat, etika». Me atë rast ai përfiton njohuri mbi fetë e ndryshme si pjesë e kulturës dhe konfrontohet me çështje etike. Kjo është pjesë e arsimimit të përgjithshëm dhe nxit të kuptuarit e botës së sotme.

Mësimi respekton pikëpamjet dhe qëndrimet e prindërve dhe të fëmijëve. Edukimi fetar i fëmijëve mbetet në përgjegjësinë e prindërve. Lënda «Fetë, kulturat, etika» nuk zëvendëson mësimin në kisha dhe në bashkësitë e tjera fetare, por as nuk e konsideron atë si një parakusht.

Veprimet fetare në shkollë nuk janë të lejuara. Për shembull, në mësim nuk lutet. Shumë më tepër, nxënëset dhe nxënësit mësojnë se kur dhe si luten njerëzit e traditave të ndryshme.

Mësimi në lëndën “Fetë, kulturat, etika” është ndërtuar ashtu që në të të mund të marrin pjesë të gjithë nxënëset dhe nxënësit pa marrë parasysh prejardhjen dhe përkatësinë e tyre fetare. Liria kushtetuese e besimit dhe ajo e bindjeve ruhet.

### **Mësimi i lëndës «Fetë, kulturat, etika» është obligues dhe jepet si vijon:**

- Klasa 1 – 6 e ciklit të ulët            1 leksion në javë
- Klasa e 1-rë e ciklit të lartë        2 leksione në javë
- Klasa e 2-të e ciklit të lartë        1 leksion në javë

Ju lutemi kontaktoni mësimdhënësen apo mësimdhënësin e fëmijës Tuaj, nëse keni pyetje. Në ueb-faqen e Entit për Shkollim Fillor («Volksschulamt») gjeni planin mësimor 21 të Cyrihut dhe informacione të tjera mbi fetë, kulturat dhe etikën:

[https://vsa.zh.ch/internet/bildungsdirektion/vsa/de/schulbetrieb\\_und\\_unterricht/faecher/mensch\\_umwelt/religion\\_und\\_kultur.html](https://vsa.zh.ch/internet/bildungsdirektion/vsa/de/schulbetrieb_und_unterricht/faecher/mensch_umwelt/religion_und_kultur.html)